



---

## E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 13.02.2023, duke filluar në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, kryesuese e komitetit, Nenad Miladinovic, Elmire Nikçi Rexha, Oktay Kurtesh, Trieria Kasumi - Berisha, Faton Marolli, Kimeta Shok, Adnan Ajeti.

**Mungoi:** Arton Brahim.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe menaxhimit të Kontratave, Ilfete Zejneli, menaxhere e kontratave në Drejtorin e Investimeve Kapitale, Lindita Hajdari, zyrtare nga Drejtoria e Kulturës, Klaudia Mula, zyrtare e ZKKK-së, Betim Abdullahu, u.d udhëheqës i ZKKK-së, Fisnik Dida, përfaqësues nga OSBE-ja, Fernando Burges, përfaqësues nga KFOR-i.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete znj. Mirsada Behluli me këtë

### R E N D T Ë D I T Ë S:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Ndihma për komunitetet jo shumicë në formë: Komuna e Prishtinës, Zyrës për Komunitete në kuadër të Qeverisë së Kosovës, MKK-së dhe donacioneve të huaja;
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave z. Krenar Xhaferi;
4. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës znj. Arta Balaj;
5. Raporti vjetor i ZKKK-së, për vitin 2022;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë për sigurinë dhe gjendjen në bashkësitë e tyre;
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete.

Pika e dytë

Ndihma për komunitetet jo shumicë në formë: Komuna e Prishtinës, Zyrës për Komunitete në kuadër të Qeverisë së Kosovës, MKK-së dhe donacioneve të huaja

**Mirsada Behluli**, kryesuese lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se të gjithë e dimë se përmes ZKKK-së, i kemi realizuar ndihmat për komunitetet jo shumicë të cilat janë në gjendje të rëndë sociale me material për ngrohje, pako higjienike dy herë në vitin e kaluar, pako ushqimore, ndihma me materiale shkollore dhe dhurata për vitin e ri për familjet të cilat janë në gjendje të rëndë ekonomiko sociale.

Ajo në vazhdim tha se besoj se të gjithë e keni lexuar emailin nga ZKKK-ja, të cilin na e ka dërguar Klaudia po ashtu edhe jeni njoftuar, mirëpo do të kisha përsëritur edhe njëherë çështjet kryesore që ka ende kohë për pakon e parë i kemi edhe shtatë ditë kurse për pakon tjetër i kemi edhe 14 ditë.

Ajo dedikohet për komunitetet jo shumicë të cilat janë në gjendje të rëndë ekonomiko sociale mund të aplikojnë për ndihmë të cilat janë të krijuara në shtatë pako të ndihmave.

Grupi i parë është për ndërtimin e shtëpive, konkursi është i hapur deri më 24.02.2023, d.m.th janë edhe 11 ditë për ata të cilët i plotësojnë kushtet.

Grupi i dytë është për renovimin e objekteve jo adekuate për pronarin i cili jeton aty me familje, si dhe dokumentacionin duhet dorëzuar deri më 24.02.2023. Unë e kam lajmëruar komunitetin tim dhe besoj se edhe ju të gjithë e keni informuar komunitetin e juaj.

Pakojë e dytë e masave është se mund të aplikojnë deri më 17.02.2023 d.m.th me ditën e sodit janë edhe pesë ditë, këtu hynë tri lloje pakosh të ndihmave si: në materialin ndërtimor, në mobileri, në pajisje elektrike, pako ushqimore dhe ato higjienike.

Dhe grupi i tretë i ndihmave ka për qëllim projektet për përmirësimin e jetës shoqërore të komuniteteve jo shumicë me maksimum ndihmë financiare prej 5000 euro. Afati është deri më 17.02.2023 d.m.th edhe pesë ditë.

Të gjitha informacionet i keni në UEB faqen e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Unë besoj se të gjithë ju përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë me kohë e keni informuar komunitetin e juaj, pasi që kjo është me të vërtetë një ofertë e mirë për të gjitha komunitetet.

**Betim Abdullahu**, tha se sa i përket MKK-së, punën më të madhe e keni ju sepse duhet të aplikoni në mënyrë vetanake secili. Unë jam takuar me zv. ministrin e MKK-së, në javën që e lamë ku e kemi diskutuar punën e projekteve ku na e ka dhënë fjalën se do të i mbështes rastet e Prishtinës, për shkak se ne e dimë se shumica e buxhetit ka shkuar në pjesën veriore, e asnjëherë nuk është shpërndarë në mënyrë proporcionale në komunat tjera.

Kështu që kishte qenë mirë me më njoftuar të paktën për krejt ato rastet e Prishtinës që kanë aplikuar që ne me mundur me e mbajt edhe një takim e me i shtyrë rastet që janë të Prishtinës. Ndërsa sa i përket pakove ushqimore dhe atyre higjienike tha se jemi në diskutim me Diakoni Kosova, një organizatë e cila realisht i ka përkrahur në Vushtrri, Mitrovicë, kurse në vitin 2023 ka me i përkrahur edhe komunat e tjera që pritet që shumë shpejt ne me e bërë një marrëveshje me na ofruar pako ushqimore dhe higjienike për familjet e komuniteteve jo shumicë si dhe për personat e riatdhesuar në Komunën e Prishtinës.

**Klaudia Mula**, tha se sa i përket subvencioneve të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, i kisha inkurajuar përfaqësuesit e komuniteteve që të i informoni familjet, sepse familjet përfituese do të jenë familjet që janë me asistencë sociale, e dimë situatën e tyre se sa ata munden me qenë të informuar edhe sa munden me qenë të vetëdijshëm që të aplikojnë ndoshta teknikisht të ju ndihmoni atyre.

Derisa edhe ne si zyre jemi të hapur për çdo nevojë që kanë ata teknikisht të ju ndihmojmë rreth aplikimit.

Ndërsa sa i përket donacioneve që UNMIK-u, ka shprehur gatishmëri me i përkrahur projektet e ndryshme, ju si përfaqësues të komuniteteve nëse keni ndonjë ide ne mund të ju ofrojmë çdo lloj mbështetje teknike ose çfarë do qoftë së bashku të aplikojmë në ndonjë projekt.

**Kimeta Shok**, shtroi pyetje se a po vazhdon ende aksioni për mbledhjen e ndihmave për tërmetin në Turqi.

**Oktay Kurtesh**, tha se aksioni është duke vazhduar mundeni të lajmëroheni në objektin "Gerçek". Ai në vazhdim tha se preferohen tekstili pra rroba, por më shumë kanë nevoja për ndriçim.

**Nenad Miladinovic**, tha se askush nga ne nuk mundet të jetë i qetë dhe kur sheh të gjitha ato incizime se çka po ndodh në Turqi dhe na vjen shumë keq për atë se çka ka ndodhur.

Ai në vazhdim tha se do të ishte mirë kur ne si Komitet të kemi në dispozicion mjete me të cilat kishim mundur të ju ndihmojmë, mirëpo ne nuk e kemi atë mundësi, mirëpo mundemi të dërgojmë një apel nga ky komitet përkrahje dhe të kërkojmë nga Komuna e Prishtinës, që të dërgoj ndonjë lloj ndihme për vendet të cilat janë përfshirë nga tërmeti.

Ai mes tjerash tha se lidhur me këtë pikë dua të shtoj se edhe diçka, kemi pasur ndihmë për dru zjarri por për fat të keq po e them se të gjitha ato familje të cilat kanë qenë në listë e që janë vërtet raste sociale e kanë nevojë nuk i kanë pranuar ato ndihma.

Prandaj unë nuk e di se çka të ju them atyre familjeve, mirëpo kisha kërkuar nga ZKKK-ja, që për takimin e ardhshëm mundësisht ta sjellin listën dhe të shqyrtojmë për çfarë arsye nuk iu është bërë lëshimi i mjeteve, sepse ka ndodhur që ka familje që nuk e kanë marrë ndihmën as vitin e kaluar e as këtë vit.

**Klaudia Mula**, lidhur me diskutimin e z. Miladinovic tha se të gjitha familjet të cilat kanë qenë në listë për të gjitha është dashur të implementohet projekti, vetëm nëse ka ndodhur

ndonjë gabim teknik qoftë ndonjë shkronjë apo ndonjë numër është gabuar atëherë ajo është kthyer mbrapa.

Edhe kjo nuk ka ndodhur vetëm me komunitetin serb por kemi edhe raste të komitetit ashkali, ndërsa komunitetet tjera nuk janë lajmëruar, mirëpo këto janë vetëm gabime teknike ndoshta vet personi i cili ka aplikuar nuk i ka dhënë të dhënat mirë.

**Nenad Miladinovic**, tha se ne i kemi plotësuar ato e jo ata persona.

**Klaudia Mula**, tha se kjo listë është përpunuar prej zyrës tonë ka shkuar në Drejtorin e Mirëqenies Sociale dhe atje janë vendosur të dhënat në një data bazë tjetër.

**Betim Abdullahu**, duke u ndërlidhur në diskutim tha se ne si zyre nuk e kemi filtruar askënd, çdo kërkesë që ka ardhur tek ne ka shkuar në drejtori përkatëse, e gabime mundet me pasur pasi që për çdo vit kemi telashe ka raste se njerëzve ju skadon afati i kartelës e ata nuk i vazhdojnë e për këtë shkak lindin problemet. Mirëpo ka raste që i kanë gabuar numrat, mirëpo do të ishte mirë që të sillni emrat dhe mbiemrat kush nuk i ka marr e t'i shikojmë se a është gabimi tek ne apo te thesari.

**Faton Marrolli**, duke u ndërlidhur në diskutim tha se gabimin duhet hulumtuar se gabimi është tek financat në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale.

Ai në vazhdim tha se ne, Klaudia dhe drejtorja jemi në rregull, por kur ka shkuar tek financat ata e kanë përcjell në Qendrën për Punë Sociale, e Qendra për Punë Sociale p.sh e kanë gjetur një emër në dy vende edhe ata nuk e kanë vetëm në njërin por i kanë larguar të dyja pra këtu është problemi.

**Mirsada Behluli**, kryesuese lidhur me rastin e mos marrjes së ndihmave tha se po ashtu edhe tek komuniteti boshnjak ka pasur problem ku një familje nuk ka marr ndihma as vitin e kaluar e as në këtë vit, pra gabimi ka ndodhur në evidentimin e numrit të llogarisë ku në vend të numrit të llogarisë ka shkuar numri i kartelës.

### **Pika e tretë**

**Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, raporti për kërkesat e pa realizuara të Komitetit për Komunitete z. Krenar Xhaferi**

**Mirsada Behluli**, kryesuese duke iu drejtuar drejtorit të Investimeve Kapitale z. Krenar Xhaferi tha se ju jeni të informuar për dy projektet në Bërnice të Poshtme, për asfaltimin e rrugës prej 2.5 kilometra, pastaj për kyçe të Ujësjellësit dhe projekti i tretë Parku për komunitetin ashkali.

**Krenar Xhaferi**, drejtor, duke u ndërlidhur në diskutimin e znj. Behluli tha se realisht unë po foli për projektin e parë dhe të tretin që jemi në realizim d.m.th është rruga "Vidovdanska", ku vlera e projektit është afërsisht 177 mijë euro.

Për shkak që ka pasur probleme jo të mira të planifikimit ne jemi detyruar që 200 mijë euro, me i tenderuar në rrjetin e kanalizimit edhe sa e kemi përcjell kontratën për tenderim, që realisht i bie një kosto prej 377 mijë euro.

Ai në vazhdim tha se kjo është bërë për arsye që vërshimet e ujit që mundën me ju hyrë atyre shtëpive mos me ndodhur si më parë.

**Elfete Zejneli**, menaxhere e kontratës, tha se nëse keni diçka problem në atë rrugë me bllokim të kanalizimeve mundeni t'i paraqitni pasi që në këto momente kemi kontratë aktive që mundemi të intervenojmë.

**Krenar Xhaferi**, drejtor tha se vitin e kaluar nuk kemi pasur kontratë për sanim të kanalizimeve. Një realizim të mjeteve në qershor e kemi si dhe i kemi ndarë 1 milion euro për sanim të kanalizimeve për krejt territorin e Komunës së Prishtinës. Kështu që në çdo moment tash që ka kërkesa jemi për intervenim.

Sa i përket Parkut në Kodrën e Trimave, tha se e kemi gjetur një hapësirë publike e në të njëjtën kohë e kemi trajtuar së bashku me Drejtorinë e Parqeve, sa i përket investimeve kanë përfunduar investimet ndërsa pjesa tjetër është investim që e bënë Drejtoria e Parqeve.

Sa i përket Slivovës tha se e kemi pasur një projekt realisht për krejt fshatrat e Gollakut që edhe Slivova hyn aty.

Ai në mes tjerash tha se të premten e kemi pasur takimin e fundit me ujësjellësin edhe kanë marr përsipër që brenda dy jave me na informuar krejt komplet për fshatrat e Gollakut, që edhe Slivova hynë fshatrat e Gollakut, edhe çfarë do alternative që e marrim atëherë e trajtojmë edhe Slivovën.

Si dhe desha të ju informoj se e kemi një buxhet të ndarë prej 300 mijë euro në vitin 2022, e që e kemi bërë deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve që me i shfrytëzuar ato mjete.

**Nenad Miladinovic**, tha se do të fokusohesha tek kjo që është duke u punuar në Bërnice dhe Poshtme dhe në Slivovë, ai projekt ka filluar punën për këtë vit dhe gjithçka ka shkuar mirë, mirëpo janë shfaqur problemet kur ka qenë problemi i kanalizimit, unë kam dal në terren për këtë projekt.

Problemi është se kur kemi të reshura të mëdha kanalizimi nuk mundet të përballoj ujin e madh, dhe ju keni vendosur të punohet në zgjidhjen e problemit të ujërave atmosferike, ku ai është projekt mjaft i shtrenjtë kjo është që diçka duhet të punohet.

Sa i përket kanalizimit tha se kapaciteti i gypave të kanalizimit është i mirë por për shkak të ujërave atmosferike shpresoj se ky projekt do të realizohet.

Ndërsa sa i përket Slivovës tha se ju keni thënë se nuk është burimi është vetëm se duhet të rregullohet rrjeti i ujit pasi që rezervuarët janë.

Ai në mes tjerash tha se drejtori e dinë atë mjaft mirë, tek ura në Bërnice dhe Poshtme kanë problem me kanalizimin zonja ka dal në terren dhe tani nëse veç e keni kontratën dhe i keni mjetet kishte me qenë mirë që të rregullohet ajo dhe të zgjidhet ai problem.

Aty është bërë problem siç e dini edhe vet me rastin e bërjes së murit mbajtës së urës janë dëmtuar gypat e ujit, si edhe para tri viteve tek lumi në Bërnice të Poshtme është shkatërruar ura e familjes Tmava, mirëpo ne i kemi premtuar se do ta rregullojmë pasi që është pronë private dhe është e rrugës që ajo të rregullohet.

Prandaj do të ishte mirë që të zgjidhet ai problem pasi që ai është rregulluar përkohësisht.

**Elfete Zejneli**, menaxhere e kontratave në DIK, duke u ndërlidhur në diskutim tha se e kemi paraparë të bëhet me beton të mbyllur edhe me e bërë si urë aty, i kemi bërë disa profile aty dhe me ua ndërtuar urën komplet.

Ajo në vazhdim tha se në Bërnice, është tenderuar kanalizimi atmosferik për ujërat të cilat derdhen në rrugë, por aty ekziston një problem edhe më i gjerë për shkak të ujërave atmosferike pasi që lumi anash duhet të pastrohet komplet, sepse aty ujërat vijnë prej Bërnices, Slivovës, prej Radashevcit dhe Sharbanit.

Pikërisht ato ujëra shkaktojnë problem edhe në kanalizime fekale dhe mund të shkaktojnë problem në kanalizimin të cilin ne e kemi tenderuar nëse nuk pastrohet uji.

**Krenar Xhaferi**, drejtor duke u ndërlidhur në diskutim tha se kjo është pjesë e Shërbimeve Publike dhe është mirë me iu drejtuar drejtorisë përkatëse.

Ndërsa sa i përket kanalizimit fekal tha se ne i kemi izoluar para dy jave, mirëpo problemi kryesor aty është që banorët duhet me lejuar vazhdimin e kanalizimit prej urës në drejtim të proçkës edhe pa e pasur pëlqimin prej tyre në atë pikë nuk mundemi të bëjmë zgjidhje.

Problemi i kanalizimit aty është që kanalizimi e donë ramjen e vet, edhe të ura po i pengon ai gypi që e përcjell prej kësaj lagje në lagjen tjetër, se nuk ka kah shkon diku tjetër ose duhet me e hekë atë ose me na lejuar banorët që ne nëpërmjet lumit me kaluar në pjesën e poshtme.

Kurse sa i përket rrjetit atmosferik që e përmendi Elfeti në rrugën "Vidovdanska" i kemi mjetet e buxhetit të këtij viti vetëm me e zgjidhur problemin e kanalizimit atmosferik.

**Oktay Kurtës**, lidhur me shqetësimin dhe kërkesat e banorëve me kanalizimin në rrugën "Ibrahim Lutfiu" dhe "Bajram Kelmendi", pra tri rrugët kryesore "Ibrahim Lutfiu", "Nazim Gafurri" dhe "Bajram Kelmendi", ku çdo herë që ka të reshura i merr uji.

**Krenar Xhaferi**, tha se në takimin që e kemi pasur me përfaqësuesit e Ujësjiellit "Prishtina" javën e kaluar për vitin 2024 jemi marr vesh që prej Komunës me i dhënë 7 milion euro, në bashkëpunim me kompani gjermane KWF për kanalizim atmosferik pikërisht për këto probleme të cilat po i diskutojmë.

Ndërsa sa i përket gropave tha se e di që ka pasur kërkesa të shumta për gropa, ku ne e kemi pasur një problem vitin e kaluar që gropat i kemi pasur me një kompani, ndërsa tash me hartën zonale, i kemi bërë me gjashtë kompani që i bie që secila kompani i ka orientimisht nga dy lagje dhe e kemi më lehtë me mbërri në secilën pikë. Si dhe besoj se prej 15 marsit, asfalti fillon me u rregulluar dhe e kemi shumë lehtë me komunikuar me secilën pjesë tash e tutje.

**Pika e katërt**

**Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, znj. Arta Balaj**

**Mirsada Behluli**, kryesuese tha se në takimin e fundit kemi biseduar lidhur me shënimin e festave nacionale për komunitetet jo shumicë, prandaj sa i përket mundësive çfarë përkrahje mundeni të na ofroni, ku besoj se shumë prej tyre kanë aplikuar.

Pra cila është mundësia e juaj të na përkrahni apo subvenciononi që të jetë e njëjtë për të gjithë, dhe nëse ka diçka të veçantë për komunitetet jo shumicë të na informoni.

**Lindita Hajdari**, zyrtare nga Drejtoria e Kulturës, tha se Drejtoria e Kulturës çdo vit hap subvencione bazuar në Rregulloren e subvencioneve në nivel nacional dhe atë lokal. aplikimet janë online.

Ndërsa sa i përket subvencionimit tha se çdo vit në bazë të kërkesave subvencionohen projektet të cilat janë në vijim, çdo herë marrim shkresa nga Zyra për Komunitete të cilat na i rekomandon, ku ne veç i kemi futur në politikat e drejtorisë që i kemi me prioritet. Ajo në vazhdim tha se çdo herë i subvencionojmë ku përveç datave të rëndësishme që komunitetet i ofrojnë normalisht çdo herë subvencionohen ato që i plotësojnë kriteret.

Kriteret janë: formohet Komision prej pesë anëtarëve, dy anëtarë janë të jashtëm ku njëri është përfaqësues i komuniteteve dhe tjetri është përfaqësues i OJQ-ve.

Ajo në mes tjerash tha se kemi edhe disa kontrata të cilat na ofrohen me kërkesa, vijnë në takime në zyre dhe ofrohen me kërkesa identike dhe ne nëse kemi mundësi me materiale promovuese i subvencionojmë, si dhe thirrjet zakonisht i hapim në muajin shkurt – mars, tash këtë javë ose në javën e ardhshme më së largu deri të mërkurën e hapim thirrjen.

Aplikimi është online në të dy gjuhët në gjuhën shqipe dhe në atë sërbe.

Pas shumë pyetjeve që u bënë nga anëtarët e Komitetit për Komunitete, znj. Hajdari tha se të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë mundë të vijnë tek ne në zyre për me parë se çka kërkojnë, nëse kërkojnë ndonjë promovim të materialit apo çka tjetër.

Ndërsa sa i përket kriterëve ato janë: kriteret në ftesë fizike d.m.th kriteret e bazës administrative dhe kriteret specifike që e bëjnë ftesën profesionale, si dhe është rregullorja në ueb faqen e Komunës.

## **Pika e pestë**

### **Raporti vjetor i ZKKK-së për vitin 2022**

**Betim Abdullahu**, tha se nuk e kisha zgjatur shumë lidhur me raportin pasi që raportin e keni marr të gjithë dhe besoj se e keni lexuar.

Ai në vazhdim tha se sa i përket projekteve e dëgjuat edhe vet drejtorin se cilat projekte janë realizuar dhe cilat priten të realizohen gjatë vitit 2023.

Kurse sa i përket sigurisë ndëretnike nuk kemi pasur probleme gjatë vitit 2022, i kemi vazhduar projektet për krejt komunitetet aq sa kemi pasur mundësi siç e dini edhe ju vet.

Ndërsa sa i përket rintegrim të huajve realisht komuniteti nuk përballet e sa i përket të kthyerve e kemi një rast i cili është në procedurë .

**Nenad Miladinovic**, bëri pyetje se deri ku ka arritur rasti i familjes Gajic.

**Betim Abdullahu**, sa i përket rastit të z. Gajic tha se ne e kemi rekomanduar në Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit. Ai realisht nuk e ka kompletuar dokumentacionin edhe pas kërkesave tona të njëpasnjëshme.

Ai në vazhdim tha se i kemi dy takime të komisionit, se për kthim nuk vendos zyra por vendos komisioni, i kemi dërguar edhe email zyrtar në atë email që na e ka sjell vet.

Realisht nuk e ka kompletuar dokumentacionin në bazë të rregullores së kthimit.

Komisioni i ka rekomanduar MKK-së, që me e lënë në listë të pritjes derisa ai të e kompletton dokumentacionin, e tash vendosmërinë finale e bënë Ministria e Kthimit.

**Nenad Miladinovic**, tha se nuk e di se për kur është paraparë formimi i Komisionit për vizitë në MKK-së dhe në zyrën e komuniteteve pranë kryeministrit, si dhe për vizitë tek kryetari i Komunës.

Pas disa diskutimesh dhe sugjerimesh u formua Komisioni për vizitë në MKK-së, dhe Zyrën për komunitete pranë Zyrës së kryeministrit.

Komisioni për vizitë tek kryetari i Komunës është me këtë përbërje: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic dhe Elmire Nikçi - Rexha.

Komisioni për vizitë tek Zyra për komunitete pranë kryeministrit të Kosovës është me këtë përbërje: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic dhe Tria Kasumi - Berisha.

Komisioni për vizitë në MKK-së, është me këtë përbërje: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic dhe Tria Kasumi - Berisha.

**Njëzëri u miratua formimi i Komisionit me përbërjen e lartë cekur.**

**Pika e gjashtë**

**Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë për sigurinë dhe gjendjen e tyre**

**Kimeta Shok**, sa i përket gjendjes së sigurisë është në rregull vetëm se kisha propozuar që për takimin e ardhshëm të ftohet drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

**Nenad Miladinovic**, sa i përket gjendjes së sigurie nuk kemi kurrfarë problemesh, po ashtu pajtohëm që për takimin e ardhshëm të ftohet drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pasi që vërtet është problem me mbeturinat që hidhen vend e pa vend, si dhe problemi tjetër janë qentë endacak.

**Pika e shtatë**

**Të ndryshme**

Mirsada Behluli, kryesuese pyeti lidhur me pajisjen e anëtarëve të Komitetit për Komunitete me kartela.

**Betim Abdullahu**, lidhur me këtë çështje duhet të bisedohet me drejtorin e Administratës. Pas shumë diskutimesh, sugjerimesh dhe propozimesh Komiteti për Komunitete nxori këto

#### **REKOMANDIME:**

1. *Komiteti për Komunitete ka propozuar që organet kompetente të Komunës së Prishtinës të gjejnë mundësi për ndihmë Turqisë dhe Sirisë, me rastin e dëmeve të tërmetit.*
2. *Të sigurohen kartelat për anëtarët e Komitetit për Komunitete ( Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok, Adnan Ajeti dhe Oktay Kurtesh);*
3. *Të përmirësohet bashkëpunimi në mes të ZKKK-së dhe Komitetit për Komunitete;*
4. *Të caktohet takimi me kryetarin e Komunës, Zyrën për Komunitete pranë Kryeministrit dhe Ministrisë së Komunitete dhe Kthim;*
5. *Të ftohet kryesuesi i Kuvendit z. Fehmi Kupina, për takimin e ardhshëm të Komitetit;*

Faqe 8 nga 9



6. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Ilirik Musliu.

*Mbledhja ka përfunduar në orën 12:30*

*Takimi i radhës do të mbahet më 22.03.2023.*

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

  
Kryesuesja e Komitetit  
Dr. Mirsada Behluli

